



GJAKOVA



Republika e Kosovës
Republika Kosova Republic of Kosovo

Komuna e Gjakovës - Opština Dakovica
Municipality of Gjakova
Drejtoria e Shëndetësisë dhe e Mirëqenies Sociale

Nr.005 /2026
Datë: 08.06.2026

REKORDI DASHË
IZLAZNE ARCHIVE
OUTPUT ARCHIVES
IV/2
Nr. Inv/Br. Inv. 05-553/01-26564
Nr.faqeve/Br. Str./No. Pg.
Data/Datum/Date 08.06.2026
Gjakovë - Djakovica - Gjakova

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Komunën e Gjakovës, në bazë të nenit 12 të Rregullores MF Nr. 04/2017 për Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të Organizatave Joqeveritare (OJQ), Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale e Komunës së Gjakovës shpall:

THIRRJE PUBLIKE

Për mbështetje financiare të projekteve të OJQ-ve në zbatimin e aktiviteteve të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale (DSHMS) e Komunës së Gjakovës fton të gjitha organizatat joqeveritare të regjistruara në Republikën e Kosovës, programet e të cilave janë të fokusuar në fushën e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale, të aplikojnë për mbështetje financiare për projekte që kontribuojnë në zbatimin e programeve të DSHMS-së, me fokus tek personat me nevoja të veçanta.

OJQ-të e regjistruara sipas legjislacionit në fuqi dhe që veprojnë në Komunën e Gjakovës mund të aplikojnë me projektet e tyre për ofrimin e shërbimeve sociale dhe rehabilituese.

Fushat prioritare të mbështetjes

Organizatave joqeveritare mund të aplikojnë me projekte që kontribuojnë në ofrimin, zbatimin dhe përmirësimin e shërbimeve për grupet e synuara në kuadër të DSHMS-së, përmes aktiviteteve si më poshtë:

- Nxitja e bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve lokale, institucioneve publike, shoqërisë civile dhe akterëve të tjerë në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me nevoja të veçanta;
- Mbështetja e aktiviteteve të edukimit joformal në fushat që mbulohen nga OJQ-të përfituese;
- Adresimi i problemeve specifike prioritare, duke përfshirë arsimin, politikën sociale, shërbimet shëndetësore, shërbimet kognitive, neuro-zhvillimore dhe fusha të tjera të ngjashme;
- Ofrimi i shërbimeve të rehabilitimit dhe trajtimit për personat me nevoja të veçanta, fëmijë dhe të rritur (persona të verbër, të shurdhër, paraplegjikë, tetraplegjikë, persona me sindromën Down, çrregullime të folurit etj.);
- Ofrimi i aktiviteteve të rehabilitimit, socializimit dhe integritit të personave me aftësi të kufizuara dhe personave me nevoja të veçanta;
- Për aktivitetet që përfshijnë ofrimin e shërbimeve të rehabilitimit, trajtimit, shërbimeve neuro-zhvillimore, kognitive, logopedike, psikologjike, fizioterapeutike ose shërbimeve të tjera profesionale të rregulluara me legjislacionin në fuqi, OJQ-të aplikuese duhet të dëshmojnë se

KOMUNA E GJAKOVËS

Drejtoria e Shëndetësisë dhe e Mirëqenies Sociale

Postal address: Bardhyl Qaushi Gjakovë, Kosovë

Tel: +381 (0) 390 320 050

<http://kk.rks-gov.net/gjakove/>

posedojnë licencat institucionale përkatëse dhe/ose personel profesional të licencuar sipas kërkesave ligjore.

Fondi i thirrjes

Vlera totale e planifikuar e kësaj thirrjeje publike është **35,000.00 €**.

Shuma minimale e mbështetjes financiare për një projekt është **500.00 €**, ndërsa shuma maksimale është **25,000.00 €**.

Afati i aplikimit

Afati për dorëzimin e aplikacioneve fillon më **08.06.2026** dhe përfundon më **26.06.2026**.

Kushtet e aplikimitOJQ-të mund të aplikojnë ose të jenë partnere vetëm në një (1) projekt në kuadër të kësaj thirrjeje.

1. Periudha e zbatimit të projektit duhet të jetë brenda vitit 2026.
2. Të drejtë aplikimi kanë OJQ-të e regjistruara sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2020 dhe dispozitave të tjera ligjore në fuqi, te cilat veprojnë në Komunën e Gjakovës, se paku një vit para datës së publikimit të Thirrjes Publike.
3. OJQ-të duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës lidhet me fushat e përcaktuara në këtë thirrje.
4. OJQ-të duhet të kenë përmbushur të gjitha obligimet financiare dhe kontraktuale sipas legjislacionit në fuqi.

Para nënshkrimit të kontratës, OJQ-të përfituese duhet të paraqesin:

- Dëshmi se personi përgjegjës dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale;
- Dëshmi për shlyerjen e detyrimeve tatimore dhe kontributeve pensionale.

Mënyra e aplikimit

Formularët e aplikimit dhe Udhëzuesi për Aplikantët janë në dispozicion në faqen zyrtare të Komunës së Gjakovës.

Aplikacionet e kompletuara duhet të dorëzohen personalisht ose me postë në adresën:

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Rr. "Bardhyl Qaushi" p.n.

50000 Gjakovë, Republika e Kosovës

Vetëm projektet e dorëzuara brenda afatit dhe që plotësojnë kushtet e kësaj thirrjeje do të merren në shqyrtim.

Për informata shtesë, të interesuarit mund të drejtohen në zyrat e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

Lulzim GOQI

Drejtor i DSHMS-së

